

Nr. 384
Dt. 18 / 11 / 2025
Prishtinë

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
BIBLIOTEKA KOMBËTARE E KOSOVËS "PJETËR BOGDANI"

UDHËZUES PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE TË BIBLIOTEKËS
KOMBËTARE TË KOSOVËS "PJETËR BOGDANI"

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Ky udhëzues në përputhje me nenin 11 dhe në ndërlidhje me nenin 10 të Ligjit Nr. 04/L-097 për Bibliotekat si dhe me nenin 12 dhe në ndërlidhje me nenin 10 të Statutit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", përcakton kushtet, procedurat dhe kriteret për dhënie në shfrytëzim të hapësirave të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" si dhe mënyrën e shqyrtimit të kërkesave të subjekteve juridike (institucioneve publike të nivelit qendror dhe lokal) për shfrytëzim të hapësirave për aktivitete kulturore, arsimore, shkencore, promovuese dhe të tjera.

Neni 2
Hapësirat që mund të jepen në shfrytëzim

1. Biblioteka mund të lejojë shfrytëzimin e këtyre hapësirave:
 - 1.1. Hapësira e jashtme (platoja/tarraca)
 - 1.2. Atriumeve
 - 1.3. Holli i ekspozitave
 - 1.4. Holli kryesor (lejohet pas orës 18:00 vetëm për institucionet publike)
 - 1.5. Hapësira e Këndit Amerikan
 - 1.6. Amfiteatrove
 - 1.7. Sallave të leximit
 - 1.8. Hapësirave të tjera të BKK-së.

Neni 3
Kriteret e përgjithshme të shfrytëzimit

1. Hapësirat mund të shfrytëzohen nga:
 - 1.1. Institucionet publike.
2. Nuk lejohet shfrytëzimi i hapësirave për:

- 2.1. Aktivitetet me karakter politik, partiak, fetar ose komercial;
- 2.2. Aktivitetet që bien ndesh me misionin e Bibliotekës dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Procedura e aplikimit dhe miratimit të lejes

1. Aplikimi për shfrytëzim bëhet me kërkesë zyrtare të dorëzuar me shkrim në adresën elektronike apo fizike të Bibliotekës.
2. Kërkesa duhet të përmbajë:
 - 2.1. Parashtruesin e kërkesës;
 - 2.2. Qëllimin dhe përshkrimin e aktivitetit;
 - 2.3. Datën, orarin dhe kohëzgjatjen;
 - 2.4. Hapësirën e kërkuar dhe numrin e pjesëmarrësve;
 - 2.5. Personin përgjegjës dhe kontaktet.
3. Vendimin për lejimin ose refuzimin e kërkesës e merr Komisioni për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të kërkesës.
4. Në raste të veçanta për shfrytëzim të hapësirave të bibliotekës, komisioni përkatës në bashkëpunim me drejtorin e Përgjithshëm të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” mund të lejojë ose refuzojë kërkesën.

Neni 5

Afatet dhe kufizimet kohore

1. Hapësirat jepen në shfrytëzim për periudha të caktuara kohore sipas natyrës së aktivitetit, por jo më gjatë se shtatë (7) ditë radhazi për të njëjtin subjekt.
2. Shfrytëzimi i hapësirave lejohet vetëm gjatë orarit zyrtar të Bibliotekës, përveç rasteve të veçanta të parapara me protokollin shtetëror dhe sipas natyrës së aktivitetit mund të lejohet kohëzgjatja e tij.

Neni 6

Përgjegjësitë e Bibliotekës

1. Biblioteka mban përgjegjësi për:

- 1.1. Lejimin e qasjes në hapësira sipas kërkesës së miratuar;
- 1.2. Mbështetjen logjistike (ndriçim, ujë, rrymë, karrige, tavolina) dhe pajisje të tjera në përputhje me kapacitetet që ka Biblioteka;
- 1.3. Mbajtjen e kalendarit dhe regjistrin të të gjitha kërkesave të parashtruara;
- 1.4. Biblioteka nuk merr përgjegjësi për pajisjet apo gjësendet e shfrytëzuesit të cilat humbin apo dëmtohen gjatë kohës së shfrytëzimit të hapësirave.

Neni 7

Detyrimet e shfrytëzuesit

1. Shfrytëzuesi është i detyruar të:

- 1.1. Mbajë rendin, qetësinë dhe higjienën gjatë aktivitetit;
- 1.2. Mos bëjë ndryshime fizike në hapësira pa pëlqim paraprak;
- 1.3. Kthejë hapësirën në gjendjen e saj të mëparshme pas përfundimit të aktivitetit;
- 1.4. T'i njoftojë zyrtarët përgjegjës të komisionit përkatës për kontroll të hapësirës së lejuar pas përfundimit të aktivitetit.
- 1.5. Të sjellë stafin e caktuar për realizimin e përgatitjeve teknike dhe organizimin e hapësirës.

2. Çdo dëmtim i pajisjeve teknike, inventarit apo infrastrukturës fizike mbulohet financiarisht nga shfrytëzuesi.

Neni 8

Pagesa dhe shërbimet shtesë

1. Shfrytëzimi i hapësirave të Bibliotekës është pa pagesë për:

- 1.1. Aktivitetet që janë në përputhje me vizionin dhe misionin publik të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani";
- 1.2. Aktivitetet kulturore, arsimore e promovuese me interes publik kombëtar.

Neni 9

Anulimi i lejes

1. Komisioni përkatës ka të drejtë ta anulojë lejen në rast të:

- 1.1. Mosrespektimit të kushteve të përcaktuara në pëlqim;
 - 1.2. Aktiviteteve që shmangen nga përmbajtja e përshkruar në kërkesë;
 - 1.3. Rrethanave të jashtëzakonshme që ndikojnë në funksionimin normal të Bibliotekës.
2. Në rast anulimi, palët njoftohen me shkrim jo më vonë se 24 orë para eventit.

Neni 10 **Mbikëqyrja dhe zbatimi**

Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzuesi e bën Drejtori i Përgjithshëm i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”.

Neni 11 **Dispozitat përfundimtare**

1. Çdo ndryshim apo plotësim i këtij udhëzuesi bëhet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”.
2. Ky udhëzues hyn në fuqi pas nënshkrimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”.

Prishtinë, 18.11 2025

Drejtoresha e Përgjithshme e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”
Blerina Rogova Gaxha

